



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I BASHKISE SE QYTETIT KORCE

VENDIM

Nr. 154 Date 22/12/2008

**“MBI PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR DHËNIEN E STIMUJVE TË
NDERIT NGA KËSHILLI I BASHKISË KORCË”**

Keshilli i Bashkise i qytetit Korce, mbledhur ne daten e sotme, pasi mori ne shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Politikave te Zhvillimit, Planifikimit strategjik e Koordinimit dhe Drejtoria Juridike “Mbi percaktimin e kriterëve per dhenien e stimujve te nderit nga Keshilli Bashkiak Korce”, bazuar ne Nenin 72, pika 1.c te Ligjit 8562, date 31.07.2000 “Per organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore

VENDOSI:

1. Te miratoje stimujt e nderit te meposhtem:

1.“QYTETAR NDERI”

2.“EMBLEMA E ARTË E QYTETIT

2.Te miratoje kriteret, pershkrimin dhe formen e stimujve, si me poshte:

1. “QYTETAR NDERI”

Është vleresimi me I larte ne stimujt që miraton Këshilli Bashkiak.

a) Ky titull ju jepet personaliteteve më të shquara që plotësojnë kriteret e përshkruara më poshtë:

-Të ketë kontribut të spikatur per qytetin e Korcës

-Të jetë I pranuar si personalitet I shquar.

-Veprimtaria e tij të jetë e vlerësuar përmes opinioneve, publikimeve të ndryshme njohese, analitike, popullarizuese.

b)- Ky stimul të shoqërohet me një protokollim standard per keto veprimtari dhe shoqërohet me nje pritje te dhene nga Bashkia deri ne shumen 50 000 leke.

2.”EMBLEMA E ARTË E QYTETIT”

a)- Ky stimul ju jepet individeve, grupeve dhe institucioneve vendase apo të huaja që me veprimtarinë e tyre, kanë dhënë e japin kontributin e tyre të spikatur në përparimin e qytetit.

b)- Veprimtaria mund të jetë atdhetare, humane, shoqërore, shkencore, kulturore. artistike, arsimore, sportive si dhe në fusha të tjera të rëndësishme.

Forma e stimujve:

- a)- Distinktivat përkatëse për të dy stimujt kanë formë, madhësi dhe kompozim , të cilat percaktohen nga Ekzekutivi në bashkëpunim me specialistë përkatës të fushës.
- b)- Në sfond duhet të jetë Emblema e Bashkisë, si simbol përfaqësues I qytetit të Korcës dhe nën te, perkatesisht shenimi: “ Qytetar Nderi”/“Emblema e arte e qytetit”
- c)- Dëshimia me motivacionin përkatës të nënshkruhet nga Kryetari I Këshillit Bashkiak dhe Kryetari I Bashkisë.

3. Te miratoje te drejten e propozimit per dhenie stimujsh nderi nga:

1. Kryetari I Bashkisë
2. Kryetari I Këshillit Bashkiak
3. 2/5 e këshilltarëve të Bashkisë
4. Komisioni I Arsim-Kulturë-Sportit I Këshillit Bashkiak
5. Institucione shkencore-arsimore apo artistiko-sportive, organizata shoqërore vendore ose kombëtare, pasi të kenë marrë mendimin me shkrim te Komisionit të Arsim-Kulture-Sportit te Këshillit Bashkiak dhe Këshillit të Kulturës pranë Bashkisë Korçë.
6. Jo më pak se 300 qytetarë me firma të legalizuara, pasi të kenë marrë mendimin me shkrim te Komisionit të Arsim-Kulture-Sportit te Këshillit Bashkiak dhe Këshillit të Kulturës pranë Bashkisë Korçë.

- Institucionet, organizatat apo grupet e cituara më lart që bëjnë propozimin, e shoqërojnë këtë propozim me dokumentacionin e plotë që e argumenton atë.

- Ky dokumentacion depozitohet në Bashki së bashku me propozimin.

4. Te shfuqizohet vendimi Nr 8, date 07.02.2005 I Keshillit Bashkiak Korce

5. Per zbatimin e ketij vendimi, ngarkohen Drejtoria e politikave te Zhvillimit, Planifikimit Strategjik dhe Koordinimit dhe Drejtoria Juridike.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

**KRYETARI
RAJMONDA NASE**

Rajmonda Nase